

ARGUMENTUM

news opinion analysis



SHBA BOMBARDON IRANIN

- Koha për të rishikuar aleancat...
- Samiti i NATOS-s në Hagë- Fitore për Trump, sfidë për Aleancën
- Kush fitoi dhe kush humbi në luftën 12-ditore mes Iranit dhe Izraelit?

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Argumentum.al tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.

Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji. Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

Argumentum.al përpaket të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexuesve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revistën Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 EDITORIAL

- Samiti i NATOS-s në Hagë- Fitore për Trump, sfida për Aleancën.

05 FOKUS

- SHBA bombardon Iranin.
- Azerbajxhani hedh poshtë pretendimet për përfshirje në konfliktin Izrael-Iran.

09 OP/ED

- Shqipëria në Detin e Hapur të Gjeopolitikës: Koha për të rishikuar aleancat...

12 JO VETEM LAJM

- Roli Destabilizues i Rusisë në Ballkanin Perëndimor/ Shqipëria si model rezistence.

14 INTERVISTA

- Ekskluzive/Ambasadori dhe shkrimtari kroat Zlatko Kramarić: Trashëgimia e Titos dhe sfidat e Ballkanit në rendin e ri botëror.

16 REALPOLITIK

- Kancelari Merz e “kaloi provimin”!

18 POLITIKË

- Sulmi amerikan ndaj Iranit/ Kryeministri Rama: Shqipëria mbështet përpjekjet e Trump kundër Iranit bërthamor.
- Parlamenti Europian miraton raportin për Shqipërinë.

20 BOTA

- Kush fitoi dhe kush humbi në luftën 12-ditore mes Iranit dhe Izraelit?

ENGLISH EDITION

23 ENGLISH TOP NEWS

- The NATO Summit in 2027 will be held in Tirana.

24 REALPOLITIK

- Summit G 6+1! The historic Summit and Trump show! Zelensky loses 0:2! Winners and losers of the 12 day war!

26 OP/ED

- Azerbaijan dismisses claims of involvement in Israel-Iran conflict.

- Elite Purges: Internal Conflict or External Design?

29 INTERVIEW

- Exclusive: “Even After Tito – Tito”/ Ambassador Zlatko Kramarić on Authoritarian Legacies and Democracy’s Future in the Balkans.

30 BALKAN OVERVIEW

- Skopje Growth Plan Summit: Western Balkans Six Urged to Accelerate Reforms.

31 GLOBAL

- NATO allies agree to allocate 5% of GDP to defense by 2035.

SAMITI I NATOS-s NË HAGË

Fitore për Trump, sfidë për Aleancën



Trumper duket se po përdor mandatin e tij të dytë për të përfunduar nismat e ndërmarra gjatë mandatit të tij të parë. Kujtojmë se gjatë presidencës së tij të parë, ai kishte deklaruar disa herë se shtetet anëtare të NATO-s duhet të kontribuonin deri në 5% të PBB-së së tyre për mbrojtjen e përbashkët.

Në Samitin e NATO-s të mbajtur në Hagë, Presidenti amerikan Donald Trump, tashmë në mandatin e tij të dytë, u rikthye fuqishëm në politikën ndërkombëtare me një kërkesë që kishte ngjallur debat të fortë gjatë presidencës së tij të parë: që vendet anëtare të NATO-s

të rrisin kontributet e tyre në mbrojtje në 5% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) deri në vitin 2035.

Me ardhjen e Joe Biden si President në Shtëpinë e Bardhë, kjo kërkesë e Trump u la në hije, ndërsa fokusi i aleancës kaloi te sfida të tjera globale. Por në samitin e NATO-s në Hagë, Trump duket se ka arritur të rikthejë në tryezë kërkesën e tij për kontribut më të madh financiar nga anëtarët

e aleancës.

Kërkesa që dikur u cilësua si “fluturake” nga kancelari gjerman Olaf Scholz tashmë ka marrë formë konkrete përmes një marrëveshjeje të re në kuadër të NATO-s.

Sipas **Deklaratës së Hagës**, vendet anëtare angazhohen për:

- **3.5% të PBB-së** në shpenzime të drejtpërdrejta ushtarake,
- **1.5% shtesë** për fusha të tilla si siguria kibernetike, industria e mbrojtjes, infrastruktura strategjike dhe rritja e qëndrueshmërisë sistemike.

Këto angazhime shënojnë një rritje të ndjeshme krahasuar me objektivin klasik 2%, dhe parashikohet një rishikim i progresit në vitin 2029.

Neni 5 në hije: garanci, por me kushte?

Edhe pse deklarata përmbyllëse riafirmon “angazhimin e pacënueshëm” ndaj Neni 5 – i ciligaranton mbrojtje kolektive në rast sulmi ndaj një anëtar, Trump la të kuptohet se përkushtimi amerikan mund të varet nga mënyra sesi “vendet respektojnë detyrimet e tyre financiare”. Kjo deklaratë shkaktoi pasiguri dhe reagime të kujdesshme nga aleatët evropianë.

Në sfond mbetet një pikëpyetje e madhe: a po zëvendësohet Neni 5 me një version më të kushtezuar të solidaritetit? Garancia për mbrojtje kolektive ekziston ende në letra, por sinjalet nga Uashingtoni lënë të

kuptohet se mbështetja mund të vijë me kushte më të ashpra.

Evropa nis të mendojë ndryshe

Trump arriti një fitore simbolike me rikthimin e objektivit prej 5% në axhendën e NATO-s, duke imponuar stilin e tij mbi një aleancë që tashmë po përgatitet për një epokë të re. Ndërkohë që disa anëtarë, si Spanja, ende nuk janë përfshirë në angazhimet e reja, të tjerë po kërkojnë alternativa strategjike për të përballuar një të ardhme me më pak garanci sigurie nga ana e Uashingtonit. Ndërsa Shtetet e Bashkuara shtyjnë për një aleancë më të barabartë, Europa po përgatitet për një të ardhme më të pasigurt, dhe ndoshta më të pavarur.

Në prapaskenë, liderët evropianë kanë nisur diskutime serioze për një autonomi strategjike më të madhe. Një

plan 5–10 vjeçar për ngritjen e kapaciteteve të përbashkëta ushtarake, reduktimin e varësisë nga SHBA dhe ndërtimin e një industrie të pavarur të mbrojtjes është tashmë në tavolinë midis Francës, Gjermanisë, Britanisë dhe vendeve nordike.

Edhe pse ekzistojnë ende kritika dhe pasiguri lidhur me mbështetjen e plotë të Shteteve të Bashkuara ndaj NATO-s, Trump ka arritur të imponojë qartë vijën e tij në politikën e jashtme. Dhe duket se ky është vetëm fillimi i një qasjeje më të ashpër dhe më transaksionale ndaj marrëdhënieve ndërkombëtare.

Trump tregoi se stili i tij transaksional dhe presioni i drejtpërdrejtë po japin rezultat. Por për NATO-n, ky është një sinjal alarmi, aleanca po përballët me një sfidë ekzistenciale: a mund të mbijetojë pa garanci të pakushtëzuara nga SHBA?



SHBA BOMBARDON IRANIN



Presidenti Donald Trump ka njoftuar se forcat e Shteteve të Bashkuara goditën tre lokacione bërthamore iraniane në një “sulm shumë të suksesshëm”, duke shtuar se objekti bërthamor i fortifikuar rëndë në Fordow është “zhdukur”, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara në konfliktin mes Izraelit dhe Iranit, duke rritur frikën për një luftë më të gjerë në Lindjen e Mesme.

Ushtria amerikane është bashkuar me Izraelin për të nisur sulme ushtarake kundër Iranit, një përshkallëzim dramatik në përpjekjet shumëvjeçare të të dy kombeve për të parandaluar Te-

heranin të pajiset me një armë bërthamore.

“Ne kemi përfunduar sulmin tonë shumë të suksesshëm në tre lokacionet bërthamore në Iran, duke përfshirë Fordow, Natanz dhe Esfahan,” shkroi Presidenti Trump në Truth Social Saturday. “Të gjithë aeroplanët tani janë jashtë hapësirës ajrore të Iranit. Një ngarkesë e plotë me BOMBA u hodh në lokacionin kryesor, Fordow. Të gjithë aeroplanët janë të sigurt në rrugën e tyre për në shtëpi. Urime Luftëtarëve tanë të mëdhenj amerikanë. Nuk ka asnjë ushtri tjetër në botë që mund ta kishte bërë këtë. TANI ËSHTË

KOHA PËR PAQE! Faleminderit për vëmendjen tuaj ndaj kësaj çështjeje.”

Të shtunën vonë në mbrëmje, Presidenti Trump iu drejtua kombit nga Shtëpia e Bardhë, i shoqëruar nga Zëvendëspresidenti Vance, Sekretari i Shtetit Marco Rubio dhe Sekretari i Mbrojtjes Pete Hegseth.

“Qëllimi ynë ishte shkatërrimi i kapacitetit të Iranit për pasurim të uraniumit dhe ndalimi i kërcënimit bërthamor që paraqet sponsori numër një shtetëror i terrorizmit në botë”.

Trump, i cili vetëm dy ditë më parë tha se do të vendoste “brenda

dy javësh” nëse do t’i bashkohej Izraelit në përpjekjet e tij për të shkatërruar objektet bërthamore iraniane, pretendoi se sulmet “shkatërruan plotësisht” objektet kyç të Iranit për pasurim të uraniumit. “Irani, bullizuesi i Lindjes së Mesme, tani duhet të bëjë paqe. Nëse nuk bën, sulmi i ardhshëm do të jetë shumë më i madh dhe shumë më i lehtë”, tha Trump.

E ardhmja e Iranit, sipas presidentit amerikan, “ose ka paqe ose tragjedi”, duke shtuar se në Iran ka ende shumë caqe që mund të goditen.

“Nëse paqja nuk vjen shpejt, ne do t’i godasim caqet e tjera me precizitet”, tha ai, duke falënderuar ushtrinë izraelite dhe atë amerikane për realizimin e operacionit. “Shpresoj të mos kemi më nevojë për shërbimet e tyre në këtë kapacitet. Shpresoj shumë”, u shpreh Trump, duke folur nga Shtëpia e Bardhë, teksa prapa tij gjendeshin nënpresidenti JD Vance, sekretari i Shtetit, Marco Rubio dhe ai i Mbrojtjes, Pete Hegseth.

Ministri i Jashtëm i Iranit, Abbas Araçhi, i quajti sulmet “të turpshme” dhe paralajmëroi se ato “do të kenë pasoja të përhershme”, në një postim në X. “Çdo shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara duhet të alarmohet nga ky veprim jashtëzakonisht i rrezikshëm, i paligjshëm dhe kriminal,” tha ai, duke shtuar se Irani “i rezervon vetes të gjitha opsionet për të mbrojtur sovranitetin, interesat dhe popullin e tij”. Transmetuesi publik izraelit, KAN, citoi një zyrtar izraelit të ketë thënë se sulmet u kryen në koordinim të plotë me Uashingtonin.

Kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, e uroi Trumpin për

sulmet “e guximshme” të SHBA-së, duke e quajtur sulmin një moment historik që mund ta çojë Lindjen e Mesme drejt paqes.

“Urime president Trump. Vendi juaj i guximshëm për të goditur objektet bërthamore të Iranit me fuqinë e jashtëzakonshme dhe të drejtë të SHBA-së do ta ndryshojë historinë”, tha Netanyahu përmes një video-adresimi.

“Presidenti Trump dhe unë shpesh themi: paqja vjen përmes forcës. Së pari vjen forca, pastaj paqja”, shtoi ai.

Senatori amerikan, republikani nga Karolina e Jugut, Lindsey Graham, gjithashtu e mirëpriti sulmin.

“Kjo ishte vendimi i duhur. Regjimi e meriton. Të lumtë, president Trump”, shkroi Graham në X.

Por, jo të gjithë e mirëpritën sulmin.

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, tha se ishte “thellësisht i alarmuar” nga përshkallëzimi.

“Ekziston një rrezik në rritje që ky konflikt të dalë shpejt jashtë kontrollit, me pasoja katastrofike për civilët, rajonin dhe botën”, tha Guterres.

Një pikë kthese

SHBA-të e kryen sulmin pavarësisht premtiveve të Trump për ta



mbajtur vendin larg përfshirjes në një konflikt tjetër në Lindjen e Mesme. Megjithatë, Trump ka thënë gjithashtu se është shumë e rëndësishme që Iranit të mos i lejohet kurrë të pajiset me armë bërthamore.


Fillimisht, Trump kërkoi të negocionte një marrëveshje të re bërthamore me Iranin – një marrëveshje që do të zëvendësonte marrëveshjen e epokës së Obamës, të cilën ai e braktisi, pavarësisht pajtueshmërisë së dukshme të Iranit, në vitin 2018. Por në ditët pas sulmeve fillestare të Izraelit ndaj Iranit në fillim të këtij muaji, ai u bë gjithnjë e më i zëshëm në kundërshtimin e tij ndaj Iranit dhe mundësinë që ai të mund të sulmonte asetet amerikane në rajon.

Trump kishte bërë thirrje për “DORËZIM TË PAKUSHTE!” të Iranit dhe u mburr në mediat sociale se SHBA-të kanë “kontroll të plotë dhe total të qiellit mbi Iranin”. Në një postim të veçantë në fillim të këtij muaji, ai kërcënoi Udhëheqësin Suprem Ajatollah Ali Khamenei, duke thënë se vendndodhja e udhëheqësit iranian ishte identifikuar.

“Ai është një objektiv i lehtë, por është i sigurt atje – Ne nuk do ta vrasim!, të paktën jo për momentin”, shkroi Trump. “Por ne nuk duam që raketat të qëllohen drejt civilëve apo ushtarëve amerikanë. Durimi ynë po shkëlqen.” Khamnei kishte kritikuar një sulm të mundshëm të SHBA-së, duke thënë në një postim në X më herët këtë muaj se SHBA-të do të hynin në konflikt “100% në dëm të vetin”.

“Dëmi që do të pësojë SHBA-ja do të jetë padyshim i pariparueshëm nëse ata hyjnë në këtë konflikt ushtarakisht”, shkroi ai.

Azerbajxhani hedh poshtë pretendimet për përfshirje në konfliktin Izrael-Iran



Nga ANAR HUSEYNOV

AMBASADOR I AZERBAJXHANIT NË SHQIPËRI

Qeveria e Azerbajxhanit i ka hedhur poshtë në mënyrë të prerë akuzat e përhapura nga mediat iraniane dhe të përforcuara nga ambasadori i Iranit në Jerevan, Armeni, që pretendojnë ndihmë ose përfshirje të Azerbajxhanit në përshkallëzimin e fundit midis Iranit dhe Izraelit. Këto pretendime provokuese janë të pabaza, të motivuara politikisht dhe synojnë të dëmtojnë imazhin ndërkombëtar të Azerbajxhanit mes tensioneve rajonale.

Zërat u shfaqën pas shkëmbimit të fundit ushtarak midis Iranit dhe Izraelit në fillim të këtij muaji, në të cilin Teherani u përball me sulme të konsiderueshme me dronë dhe raketa. Mediat pro-qe-

veritare në Iran, së bashku me zyrtarë të lartë si ambasadori iranian në Armeni, bënë insinuata të pabaza se Azerbajxhani i kishte ofruar mbështetje logjistike, konkretisht lejimin e inkursionit të dronëve izraelitë nga Azerbajxhani, ose mbështetje inteligjence Izraelit në këtë operacion.

Në përgjigje, Ministria e Punëve të Jashtme të Azerbajxhanit lëshoi një deklaratë të fortë duke mohuar çdo përfshirje në konflikt. “Këto pretendime minojnë marrëdhëniet midis Azerbajxhanit dhe Iranit që bazohen në respektin e ndërsjellë për integritetin territorial dhe sovranitetin e njëri-tjetrit, dhe mos-ndërhyrjen në punët e brendshme. Republika e Azerbajxhanit hedh poshtë kategorikisht akuzat se hapësira e saj ajrore ose territori i saj është përdorur nga ndonjë shtet për të kryer operaci-

one ushtarake kundër Republikës Islamike fqinje të Iranit ose ndonjë vendi tjetër. Pretendime të tilla janë të pabaza dhe pa asnjë provë të besueshme,” tha Aykhan Hajizada, Zëdhënës i MPJ-së, në një konferencë zyrtare.

Azerbajxhani ka theksuar se politika e tij e jashtme bazohet në parimet e mos-ndërhyrjes, bashkëpunimit rajonal dhe respektit për sovranitetin e të gjitha shteteve. Baku ka ripërsëritur se gjithmonë ka qenë përkrahës për zgjidhjen paqësore të konflikteve dhe nuk ka interes të përfshihet në armiqësi që nuk i shërbejnë interesave të tij kombëtare apo stabilitetit rajonal.

Një nga shtyllat qendrore të politikës së jashtme të Azerbajxhanit që nga rifitimi i pavarësisë ka qenë nxitja e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe me përfitim

të ndërsjellë me të gjithë fqinjët e tij, përfshirë Republikën Islamike të Iranit. Baku ka shprehur vazhdimisht gatishmërinë për t'u angazhuar në dialog të hapur, të barabartë dhe konstruktiv me Teheranin për të gjitha çështjet dypalëshe dhe rajonale.

Vala e fundit e akuzave duhet parë në kontekstin e qajes së njëanëshmë të kahershme të Iranit ndaj Azerbajxhanit, veçanërisht gjatë periudhave me rëndësi kombëtare dhe ndjeshmëri rajonale. Për gati tre dekada, Irani mbajti një qëndrim dukshëm pro-armen gjatë pushtimit të territoreve të Azerbajxhanit nga Armenia. Pavarësisht njohjes ndërkombëtare të integritetit territorial të Azerbajxhanit, përfshirë rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së që kërkonin tërheqjen e menjëhershme të forcave armene, Teherani mbajti lidhje të ngushta politike, ekonomike, energjetike dhe transporti me Jerevanin—duke anashkaluar në mënyrë të vazhdueshme të drejtat dhe gjendjen e vështirë të rreth një milion personave të zhvendosur dhe refugjatëve azerbajxhanas të shkakuar nga pushtimi armen.

Lufta e Dytë e Karabakut e vitit 2020 nxorri në pah më tej qëndrimin kontradiktore të Iranit. Në vend që të mbështeste rivendosjen e ligjshme të kufijve të njohur ndërkombëtarisht, Teherani përsëri sinjalizoi shqetësimin e

Lufta e Dytë e Karabakut e vitit 2020 nxorri në pah më tej qëndrimin kontradiktore të Iranit. Në vend që të mbështeste rivendosjen e ligjshme të kufijve të njohur ndërkombëtarisht, Teherani përsëri sinjalizoi shqetësimin e tij me sukseset ushtarake të Azerbajxhanit, shpesh duke shprehur shqetësime më të lidhura me interesat armene sesa me drejtësinë apo të drejtën ndërkombëtare.

tij me sukseset ushtarake të Azerbajxhanit, shpesh duke shprehur shqetësime më të lidhura me interesat armene sesa me drejtësinë apo të drejtën ndërkombëtare. Përveç kësaj, gjatë luftës, Irani, ndryshe nga vendet e tjera të rajonit, ofroi korridor tranziti për furnizime ushtarake për Armeninë nga vende të treta, si dhe kontribuoi vetë me mjete politike dhe dispozita përkatëse, duke përfshirë furnizimin me karburant për ish-regjimin separatist të Karabakut.

Presidenti Ilham Aliyev e ka adresuar këtë pabesi në disa fjalime. “Ndërsa Azerbajxhani po çlironte tokat e veta nga pushtimi, disa fqinjë jo vetëm që nuk na mbështetën, por haptazi mbështetën agresorin. Historia dëshmon pozicionin e secilit, në kohën kur drejtësia po rivendosej,” tha ai në një fjalim pas lufte në dhjetor 2020.

Ne shohim një model—sa herë që ka trazira të brendshme ose

përkeqësim të marrëdhënieve me vende të treta, makineria mediatike e Teheranit apo edhe zyrtarët gjejnë narrativa të përshtatshme jashtë vendit, shpesh duke shënjestruar Azerbajxhanin pa prova.

Ndërsa dinamikat rajonale dhe globale evoluojnë, Azerbajxhani vazhdon të promovojë një vizion të zhvillimit rajonal gjithëpërfshirës, bashkëpunimit ndërkufitar dhe prosperitetit të përbashkët. Në këtë drejtim, Baku i ka bërë thirrje vazhdimisht Iranit të shmangë nxitjen e paqëndrueshmërisë rajonale dhe të përmbahet nga përhapja e dezinformatave që mund të dëmtojnë marrëdhëniet afatgjata të fqinjësisë. Qëndrimi i Azerbajxhanit mbetet i qartë: ai nuk ka marrë pjesë, nuk ka mbështetur dhe nuk ka lehtësuar asnjë veprim ushtarak kundër Iranit. Pretendimet e pabaza nga zëra të caktuar të fqinjit tonë, siç u përmend më sipër, pasqyrojnë një prirje më të gjerë historike të njëanshmërisë dhe standardeve të dyfishta të Iranit në Kaukazin e Jugut. Pra, ne shpresojmë se Teherani do të adoptojë një qasje më konstruktive dhe të bazuar në fakte ndaj politikave të tij të fqinjësisë, e mbështetur në respektin e ndërsjellë, të drejtën ndërkombëtare dhe të përqendruar në paqe dhe bashkëpunim.



SHQIPËRIA NË DETIN E HAPUR TË GJEOPOLITIKËS: KOHA PËR TË RISHIKUAR ALEANCAT...



Nga Marjana DODA

“Amerika nuk ka miq ose armiq të përhershëm, por vetëm interesa.”

(America has no permanent friends or enemies, only interests)- Henry Kissinger

Kjo thënie e Henry Kissinger-it, një prej arkitektëve më të sofistikuar të diplomacisë së shekullit të 20-të, na kujton një të vërtetë të thjeshtë por thelbësore në marrëdhëniet ndërkombëtare: në fund të ditës, çdo shtet udhëhiqet nga interesi i tij kombëtar.

Asgjë nuk ka ndryshuar në politikën e jashtme amerikane, përveç njerëzve që e drejtojnë atë; filozofia mbetet e njëjtë dhe këtë filozofi po e reflekton qartë Donald Trump si presidenti i 47-të i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Qasja më e përmbajtur e Trump ndaj Rusisë dhe qëndrimi kritik ndaj aleatëve tradicionalë si Bashkimi Evropian, Kanadaja apo Britania e Madhe në kuadër



të politikës së tij proteksioniste, “Amerika e Para” (“America First”), tregojnë qartë se boshti i vendimmarrjes është interesi kombëtar, dhe jo aleancat historike apo ideologjike. Në një rend botëror që po ndryshon me ritme të shpejta, logjika e realpolitikës po kthehet në normën e re ndërkombëtare. Prandaj, pyetja që lind natyrshëm është: A duhet që edhe vende të vogla, por me peshë gjeostrategjike si Shqipëria, të ndjekin një politikë të jashtme të bazuar mbi interesin kombëtar, duke ruajtur fleksibilitetin në një botë shumëpolare?

Shqipëria nuk është më një njësi gjeografike e izoluar në Ballkan. Sot, ajo është anëtare e NATO-s, vend kandidat për Bashkimin Evropian dhe gjithnjë e më e pranishme në zhvillimet rajonale dhe ndërkombëtare. Roli i saj strategjik në Evropën Juglindore është i njohur. Në këtë kontekst, interesi

kombëtar i Shqipërisë duhet të përfshijë ruajtjen e stabilitetit të brendshëm, paqen në rajon, përshejtimin e integritetit evropian dhe zhvillimin e një ekonomie konkurruese. Por këto objektiva kërkojnë vizion, strategji, kapacitet institucional dhe një politikë të jashtme të guximshme.

Shqipëria është përfshirë tashmë në zhvillime të rëndësishme gjeopolitike. Nga strehimi i muxhahedinëve iraniane, te mbështetja për sanksionet perëndimore kundër Rusisë dhe qëndrimi gjithnjë e më i kujdesshëm ndaj Kinës. Të gjitha këto e kanë vendosur vendin në një pozicion të ekspozuar, shpesh në vijën e zjarrit të intereseve globale, por pa përfitime të qarta dhe të matshme në raport me rreziqet që këto vendime kanë sjellë.

Rasti i muxhahedinëve iraniane (MEK), për shembull, është emblema e një vendimi të rëndës

sishëm politik i cili e ka bërë Shqipërinë një objektiv të vazhdueshëm të Teheranit, si në planin diplomatik ashtu edhe në atë kibernetik, siç u dëshmuua me sulmin masiv ndaj sistemeve shtetërore në vitin 2022. Nëse ky vendim ka prodhuar një garanci konkrete të mbështetjes amerikane ose europiane për Shqipërinë ekonomike, ushtarake apo zhvillimore, kjo mbetet ende e paqartë.

Marrëdhëniet me Rusinë janë shkëputur pothuajse plotësisht, me një linjë të rreptë dhe pa fleksibilitet diplomatik, në përputhje me qëndrimin amerikan dhe evropian për pushtimin rus të Ukrainës. Qëndrimi i qartë dhe i prerë i Shqipërisë kundër pushtimit rus të Ukrainës dhe mbështetja ndaj sanksioneve perëndimore e ka vendosur vendin në anën e duhur moral dhe ndërkombëtar, por ka prodhuar gjithashtu shkëputje totale nga çdo kanal diplomatik me Rusinë, ndaj një fuqie që, pavarësisht kundërshtimeve të mëdha politike, vazhdon të ketë ndikim real në Ballkan, dhe më gjerë.

Turqia, Hungaria, Serbia dhe madje edhe vende si Izraeli kanë ruajtur ura komunikimi me Moskën, duke ndjekur një politikë më të balancuar që mbron interesat e tyre kombëtare pa sakrifikuar parimet. Shqipëria, përkundrazi, ka zgjedhur një linjë të ashpër dhe monodimensionale. Ndërsa me Kinën, Shqipëria ka zgjedhur të qëndrojë në heshtje, duke humbur mundësi për investime dhe bashkëpunime që fqinjët tanë (si Serbia apo Greqia) i kanë shfrytëzuar në mënyrë pragmatike.



Marrëdhëniet me Qëndrimi i qartë dhe i prerë i Shqipërisë kundër pushtimit rus të Ukrainës dhe mbështetja ndaj sanksioneve perëndimore e ka vendosur vendin në anën e duhur moral dhe ndërkombëtar, por ka prodhuar gjithashtu shkëputje totale nga çdo kanal diplomatik me Rusinë, ndaj një fuqie që, pavarësisht kundërshtimeve të mëdha politike, vazhdon të ketë ndikim real në Ballkan, dhe më gjerë.



Kina ka pasur një lidhje historike të veçantë me Shqipërinë në periudhën e izolimit komunist, por në dekadat e fundit, mungesa e një politike të qartë ndaj Pekinit ka bërë që Shqipëria të mbetet jashtë iniciativave të mëdha kineze si “Brez dhe Rrugë”, apo projektet infrastrukturore të mbështetura në rajon.

Ndryshe nga Serbia, Maqedonia e Veriut apo Mali i Zi që kanë përfutur nga investimet kineze, Shqipëria ka mbetur vendnumëro, duke e parë Kinën si një pjesë e respektuar e së kaluarës, por jo si aktor të së ardhmes. Një qasje që kërkon rishikim të menjëhershëm në një botë ku Azia po shndërrohet në epiqendër zhvillimi.

Në vend që të qëndrojë në heshtje, Shqipëria ka shumë arsye për të zhvilluar marrëdhënie ekonomike më të fuqishme me Kinën, duke marrë mësim edhe nga historia e saj e gjatë dhe periudha e vështirë e viteve '90-të, ku pavarësisht sfidave, marrëdhëniet mes dy vendeve kanë pasur një dimension pozitiv dhe pragmatik. Kina nuk vjen me ideologji apo dogma politike që mund të kufizojnë sovranitetin apo zgjedhjet e Shqipërisë; ajo sjell një ofertë bashkëpunimi ekonomik, të ndërtuar mbi interesa të ndërsjella, ku përfitimet matën në zhvillim, investime dhe avancim teknologjik.

Në një botë ku fuqia ekonomike po bëhet shtylla kryesore e ndikimit global, dhe ku aleancat bazohen gjithnjë e më shumë në përfitime konkrete dhe jo në besnikëri ideologjike, Shqipëria ka nevojë të ndjekë një politikë të jashtme pragmatike. Në këtë kuadër, Shqipëria duhet të rishikojë me realizëm balancën e saj midis Lindjes dhe Perëndimit, duke ndërtuar lidhje strategjike edhe me vende si Kina, Rusia apo dhe me vende të tjera të grupimit BRICS.

Veçanërisht urgjente është që Shqipëria të forcojë marrëdhëniet me Kinën, një aktor kryesor ekonomik. Përfitimet nga iniciativa si “Brez dhe Rrugë” dhe investimet në sektorët e infrastrukturës, energjisë dhe teknologjisë duhet të shfrytëzohen maksimalisht, duke ruajtur në të njëjtën kohë dhe angazhimin euroatlantik.

Ky bashkëpunim nuk duhet parë si një kundërshtim ndaj partnerëve tradicionalë, por si një

strategji e zgjuar për t'i dhënë Shqipërisë më shumë hapësirë manovre dhe mundësi zhvillimi në një botë shumëpolare ku interesat janë të ndryshme dhe ndryshojnë me kohën.

Flas për Kinën dhe Rusinë, sepse Shqipëria ka një marrëdhënie historike, kulturore dhe ekonomike me këto dy vende. Sot, ato po ndikojnë thellësisht në formimin e rendit të ri botëror. Për më tepër, Kina dhe Rusia përbëjnë dy fuqi botërore që është e pamundur t'i neglizhosh apo t'i shmangësh.



Një botë në kalim epokal

Ajo që po dëshmojmë sot, është se Bota po përjeton një fazë transformimi të rrallë historike, ku rendi i pas Luftës së Dytë Botërore, i ndërtuar mbi dominimin perëndimor po zëvendësohet nga një rend shumëpolar.

Kina dhe Rusia po ndërtojnë një bosht të ri euro-aziatik, ndërkohë që vendet e të ashtuquajturit "Jugu Global" (Global South) po zgjedhin me kujdes partnerët e tyre, jo më mbi baza ideologjike, por mbi interesa konkrete ekonomike dhe politike. Në këtë botë të fragmentuar, aleancat nuk janë të përhershme, por të ripërtëritshme. Ato duhet të mbështeten në vlerësimin realist të interesave kombëtare dhe jo vetëm në ndjenjën e besnikërisë ndaj një kampi të caktuar.

Shqipëria duhet të pozicionohet me zgjuarsin në këtë rend të ri. Ajo duhet të mbajë të palëkundur boshtin e saj euroatlantik, por njëkohësisht të ndërtojë ura strategjike me fuqitë lindore dhe me vendet që përfaqësojnë alternativa të reja zhvillimi dhe ndikimi. Kjo nuk është një thirrje

Shqipëria duhet të pozicionohet me zgjuarsin në këtë rend të ri. Ajo duhet të mbajë të palëkundur boshtin e saj euroatlantik, por njëkohësisht të ndërtojë ura strategjike me fuqitë lindore dhe me vendet që përfaqësojnë alternativa të reja zhvillimi dhe ndikimi. Kjo nuk është një thirrje për shkëputje, por për hapje. Nuk është një sfidë ndaj SHBA-së apo BE-së, por një kërkesë për të ushtruar sovranitet diplomatik në funksion të interesit kombëtar.

për shkëputje, por për hapje. Nuk është një sfidë ndaj SHBA-së apo BE-së, por një kërkesë për të ushtruar sovranitet diplomatik në funksion të interesit kombëtar.

Në një botë që po përjeton një transformim të rrallë historik, Shqipëria nuk mund të jetë spektatore. Ajo duhet të ndërtojë një politikë të jashtme me vizion, që jo vetëm ruan aleancat ekzistuese, por edhe kërkon partneritete të reja në ekonomi, teknologji, energji, arsim dhe kulturë. Ajo duhet të dalë nga roli i vendit të vogël që ndjek të tjerët,

për të marrë rolin e një aktori të mençur që luan në të gjitha tavolinat dhe që vendos vetë për interesat e veta. Koha e diplomacisë së ngurtë ka kaluar. Sot nevojitet një politikë e jashtme e zgjuar, fleksibile dhe mbi të gjitha e orientuar drejt interesave kombëtare, jo e lidhur me ideologji apo varësi.

Në fund të fundit, siç na kujton Kissinger, nuk ka miq apo armiq të përhershëm. Ka vetëm interesa. Dhe Shqipëria ka të drejtën dhe detyrimin t'i mbrojtë të sajat, në një botë që nuk pret dhe nuk fal ata që mbeten pas.

Roli Destabilizues i Rusisë në Ballkanin Perëndimor/ Shqipëria si model rezistence



Nga DRAGAN ŠORMAZ*

“Rusia në Ballkanin Perëndimor ka një potencial destabilizues që shfaqet kryesisht përmes ndikimit të saj mbi rrethet politike të ekstremit të djathtë të lidhura me Kishën Ortodokse Serbe (KOS), përmes të cilave synon të destabilizojë rajonin dhe të pengojë integrimin e tij në BE dhe NATO. Në këto përpjekje, Rusia mundohet të thellojë ndarjet ndëretnike dhe të shkaktojë incidente që do ta çonin rajonin në prag të konflikteve të armatosura, duke e kthyer në situatën e viteve '90 të shekullit të kaluar”, shkruan ish politikanin serb, tashmë ekspert i sigurisë Dragan Šormaz.

Sipas një analize nga eksperti i sigurisë Dragan Šormaz, ndërhyrja e Rusisë synon ta mbajë

Ballkanin në një gjendje paqëndrueshmërie të përhershme, duke evokuar spektrin e dhunshëm të viteve 1990. Në artikullin e tij për The Geopost, Šormaz përshkruan se si Kremli mbështetet në qarqet nacionaliste të lidhura me KOS-in në Serbi për të kryer luftën e tij hibride – nga nxitja e urrejtjes etnike deri te organizimi i provokimeve të fshehta.

Argumentum.al sjell disa nga pika kyçe të kësaj analize;

Shqipëria: Një Model i Rezistencës

Në të kundërt, Shqipëria qëndron si një rast unik i rezistencës. Siç vëren Šormaz, ndikimi i Rusisë në vend është “aktualisht në nivelin më të ulët” për shkak të orientimit të qartë dhe të qëndrueshëm pro-perëndimor të Tiranës. Shqipëria, anëtare e

NATO-s që nga viti 2009 dhe kandidate për anëtarësim në BE, ka përparuar me shpejtësi në negociatat me Brukselin – duke tejkaluar progresin shtatëvjeçar të Serbisë në vetëm shtatë muaj.

Kisha Ortodokse Shqiptare, e lidhur me botën ortodokse greke dhe jo me Patriarkatin Ruse, është një faktor tjetër që kufizon pikat e hyrjes fetare dhe kulturore të Moskës. Šormaz argumenton se kjo është “prova më e fortë se Kisha Ruse funksionon si një zgjatim i regjimit kriminal të Kremlinit”.

Edhe në fushën dixhitale, Shqipëria është treguar e qëndrueshme. Megjithatë një sulm i madh kibernetik me origjinë nga Irani shënjestroi vendin pasi mbështeti Ukrainën dhe sanksionet e BE-së kundër Rusisë, ndikimi i drejtpërdrejtë rus ka qenë i papërfillshëm deri më

tani. Operacionet e propagandës dhe dezinformimit janë përpjekur të depërtojnë, por me sukses të kufizuar.

“Shqipëria është shembulli më i mirë në Evropën Juglindore që tregon se sa e rëndësishme është të distancohesh nga Moska nëse dëshiron paqe, liri dhe përparim ekonomik – në fakt, është një shembull edhe më i mirë se Kroacia”, shkruan Šormaz.

Kosova: Leva e Moskës mbi Beogradin

Një nga mjetet më strategjike të Rusisë në rajon mbetet statusi i pazgjidhur i Kosovës. Duke kundërshtuar me vendosmëri pavarësinë e Kosovës në OKB, Moska vazhdon të ndikojë në politikën dhe opinionin publik serb. Ndërsa Rusisë i mungon ndikimi i drejtpërdrejtë shoqëror në Kosovë, mbështetja e saj politike për fraksionet ekstremiste serbe në veri e mban rajonin në tension të vazhdueshëm.

Šormaz thekson paralelet e nxjerra nga propaganda ruse midis gjendjes së supozuar të serbëve në Kosovë dhe asaj të rusëve në Donbas – duke thirrur për “denazifikim” dhe duke akuzuar Perëndimin për komplotimin e pushtimit të tokave serbe.

Një zhvillim veçanërisht shqetësues ishte sulmi terrorist i shtatorit 2023 në Banjska, i udhëhequr nga Milan Radoičić, një figurë kontraverse me lidhje të supozuara me qeverinë serbe dhe rrjetet pro-ruse. Ndërsa Šormaz pohon se Rusia ka të ngjarë të ketë luajtur vetëm një rol këshillues, ai sugjeron se operacioni është orkestruar nga Presidenti serb Aleksandar Vučić – një pretendim që, thotë ai, pret shqyrtim ligjor në Prishtinë.



Maqedonia e Veriut: Një fushë beteje për ndikim

Përpjekjet e Rusisë në Maqedoninë e Veriut kanë qenë më të dukshme, por në fund të fundit të kufizuara, falë anëtarësimit të vendit në NATO që nga viti 2020 dhe progresit gradual drejt BE-së. Kremli kundërshtoi fuqimisht Marrëveshjen e Prespës dhe pranimin e Maqedonisë së Veriut në NATO, duke punuar në mënyrë aktive për të minuar këto përpjekje përmes partive pro-ruse dhe dezinformimit.

Sipas Šormaz, një përpjekje e dështuar për grusht shteti në prill 2019, gjatë së cilës kryeministri i atëhershëm Zoran Zaev i shpëtoi mezi vrasjes, mbante gjurmët e inteligjencës ruse dhe serbe. Raportet nga shërbimet e sigurisë maqedonase madje e përmendin Miroslav Lazanskin, një gazetar serb të shndërruar në ambasador në Moskë, si një figurë me interes.

Megjithatë kthimi i fundit politik i partisë pro-ruse VMRO-DPMNE ngre shqetësime, vendi ka forcuar rezistencën e tij ndaj ndikimit rus – si në nivel institucional ashtu edhe shoqëror.

Ndarja e shqiptarëve |nga Perëndimi

Në të gjithë rajonin, operacionet ruse përballen me pengesën më të madhe në komunitetet etnike shqiptare, të cilat mbeten kryesisht pro-perëndimore. Nga Tirana në Prishtinë e deri në Tetovë, ka pak simpati për narrativat ruse. Megjithatë, Šormaz paralajmëron se Moska nuk është dorëzuar: po bëhen përpjekje për të mbjellë dyshime, për të dobësuar besimin në NATO dhe BE, dhe për t'i portretizuar Shqipërinë dhe Kosovën si kukulla perëndimore.

Megjithatë, Shqipëria mbetet një kundërshtues i gjeostrategjik: provë se integrimi euroatlantik, transparenca dhe institucionet e forta civile janë antidoti më i mirë ndaj ndikimit gërryes të Moskës.

*Rreth Autorit:

Dragan Šormaz është politikan dhe analist i çështjeve të sigurisë nga Serbia, i cili ka qenë deputet në Kuvendin Kombëtar të Serbisë në periudhën 2001–2022. Ai është i njohur për qëndrimin e tij në mbështetje të integritetit euroatlantik të vendit.

EKSKLUZIVE

Ambasadori dhe shkrimtari kroat Zlatko Kramarić: Trashëgimia e Titos dhe sfidat e Ballkanit në rendin e ri botëror

Intervistë ekskluzive për Argumentum.al me SH.T.Z. Zlatko Kramarić, Ambasador i Republikës së Kroacisë në Shqipëri dhe Autor i librit "Edhe pas Titos – Tito"

Nga MARJANA DODA

Në një kohë kur Ballkani përballlet me tensione të reja politike, kthim të diskurseve nacionaliste dhe një sfond gjeopolitik gjithnjë e më të fragmentuar, vjen libri më i ri i autorit dhe diplomatit kroat Zlatko Kramarić, me titullin provokues Dhe pas Titos – Tito. Libri nuk është një biografi e diktatorit jugosllav, por një analizë e thellë politike mbi mënyrën se si trashëgimia autoritare ka vazhduar të dominojë jetën publike edhe pas rënies së regjimeve totalitare në Ballkan.

Në këtë intervistë ekskluzive për Argumentum.al, Kramarić reflekton mbi "Titoizmin pa Titon" dhe konceptin paralel të "Enverizmit pa Enverin", mbi kulturën politike të liderit të pazëvendësueshëm dhe mbi rrezikun e rikthimit të formave të autoritarizmit nën petkun e demokracisë. Ai analizon edhe sfidat e mëdha të rajonit në kuadër të një rendi të ri botëror, ku fuqitë e mëdha rikthejnë interesat në Ballkan.

Me qartësinë e një intelektuali dhe ndjeshmërinë e një diplomati të angazhuar për të ardhmen e rajonit, Kramarić u përgjigjet



pyetjeve që lidhen jo vetëm me të kaluarën, por edhe me të ardhmen e mundshme të Ballkanit Perëndimor.

Sipas Kramarić, titulli i librit është qëllimisht provokues dhe shumëkuptimësh. "Nuk është një libër për Titon si figurë historike, por për titoizmin pa Titon – për ato sjellje politike dhe mentalitete që mbijetuan edhe pas rrëzimit të sistemit komunist. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për enverizmin pa Enverin në Shqipëri."

Për Kramarić, përvoja shqiptare e izolimit ekstrem dhe diktaturës totale, ndonëse unike, nuk e për-

jashton Shqipërinë nga fenomenet e zakonshme të rajonit. Përkundrazi, ai sheh ngjashmëri të thella mes Shqipërisë dhe Kroacisë post-komuniste: mungesë besimi te institucionet, personalizim i pushtetit dhe prirje për t'i dhënë përparësi liderëve karizmatikë mbi sistemet demokratike.

"Po, ende ekziston një kulturë politike në Ballkan që e sheh liderin si të pazëvendësueshëm," thekson ai. "Kjo është trashëgimi e sistemeve autoritare të së kaluarës – nga monarkitë, te diktaturat dhe regjimet njëpartiake. Demokracia në këtë rajon është

Përvoja shqiptare e izo-limit ekstrem dhe diktaturës totale, ndonëse unike, nuk e përjash-ton Shqipërinë nga fenomenet e zakonshme të rajonit. Përkundrazi, ai sheh ngjashmëri të thella mes Shqipërisë dhe Kroacisë post-komuniste: mungesë besimi te institucionet, personalizim i pushtetit dhe prirje për t'i dhënë përparësi liderëve karizmatikë mbi sistemet demokratike.

“Po, ende ekziston një kulturë politike në Ballkan që e sheh liderin si të pazëvendësueshëm,” thekson ai. “Kjo është trashëgimi e sistemeve autoritare të së kaluarës – nga monarkitë, te diktaturat dhe regjimet njëpartiake. Demokracia në këtë rajon është ende e brishtë, me rrënjë të cekëta dhe e ekspozuar ndaj manipulimeve populiste apo mediatike.”



ende e brishtë, me rrënjë të cekëta dhe e ekspozuar ndaj manipulimeve populiste apo mediatike.”

Kramarić nuk e ndalon kritikën vetëm te rajoni. Ai e lidh situatën e Ballkanit me prirjet globale drejt populizmit dhe rritjes së regjimeve hibride, që përdorin gjuhën demokratike por i përmbahen praktikave autoritare. “Fenomeni nuk është thjesht një ‘sëmundje ballkanike’ – ai është pjesë e një krize globale të demokracisë.”

Në këtë kuadër, ai paralajmëron

se Ballkani Perëndimor është gjithnjë e më shumë në rrezik të bëhet sërish një zonë përplasjesh mes fuqive të mëdha. “Interesi i shtuar i Rusisë, ndikimi i Kinës, dhe dobësia e përgjigjes europiane po krijojnë një terren të rrezikshëm – veçanërisht për Kosovën dhe Bosnjën, ku kërcënimet nga Serbia mbeten të vazhdueshme,” thotë ai.

Edhe pse kritikën e tij janë të forta dhe analiza shpeshherë pesimiste, Kramarić nuk heq dorë nga shpresa. “E kaluara në Ballkan nuk është thjesht histo-

ri – ajo përdoret sot si justifikim politik. Por kjo nuk do të thotë që demokracia është e paarritshme. Është e vështirë, kërkon durim dhe vullnet për të parë përtej miteve.”

Për lexuesin shqiptar, Edhe Pas Titos – Tito është një ftesë për reflektim të thellë. “Nuk kam dashur të jap përgjigje, por të ngre pyetje. Pyetje të pakëndshme ndoshta – për pushtetin, historinë, kujtesën dhe heshtjet që zgjasin më shumë se diktaturat,” thekson Ambasadori dhe shkrimtari kroat Zlatko Kramarić.

KANCELARI MERZ E “KALOI PROVIMIN”!

Çmenduri politike! 5 për qind ose ndryshe mësoni rusisht! Lindja e Zjarhtë!

REAL POLITIK NR. 109 | 1 – 16 QERSHOR 2025 | EKSLUZIVE PËR ARGUMENTUM

Komente “flash” mbi 4 ngjarjet kryesore diplomatike, shkurt dhe shqip, vetëm me 1000 fjalë nga analisti i njohur

DR. JORGJI KOTE *GRAND MASTER*

1.

Kancelari Merz e “kaloi provimin”! Mund të tingëllojë eçuditshme, por takimi i Kancelarit gjerman Friedrich Merz më 6 Qershor në Shtëpinë e Bardhë me Presidentin Trump ishte vërtet test i madh shkollor politik! Si ish diplomat në Berlin dhe falë gjermanishtes, ndoqa stresin, emisionet dhe pikpyetjet e shumta lidhur me përgatitjet paraprake të “Studentit Merz” në muajin e parë si Kancelar përballë “Profesorit” të tij President të paparishikueshëm Trump: Përpara fluturimit në Uashington, Merz telefonoi homologët britanikë, francezë, italianë, dhe Presidentin Zelenski pas takimit scandaloz më 28 Shkurt në Zyrën Ovale për të dëgjuar sugjerimet e tyre taktike; ai bisedoi me psikologë dhe ekspertë të gjuhës së trupit, deri si ta thoshte sa më bukur dhe “Thank you”! Këshilltarët e tij më të afërt kaluan netë pa gjumë, duke vrarë mendjen për çdo situatë që mund të krijohet dhe si të dilej “pa u lagur”. Gjithashtu, Merz kishte me vete një garderobë me 16 kostume për t’i patur për çdo rast. Në fakt, Merz ishte me shumë fat për atë “provim”. Ditën e takimit



ishte njoftuar prishja e miqësisë së Trump me Elon Musk. Nga ana tjetër, gjesti i Trump për ta akomoduar Mercin në Shtëpinë Presidenciale “Blair” ishte mesazh dhe ogur i mirë për takimin në fjalë. Hyrja më e bukur në bisedën e tyre ishte padyshim zgjedhja domethënëse e dhuratës, akti origjinal gjerman i lindjes së gjyshit të Trump, Friedrich që në Amerikë e kishte kthyer në Frederik që e preku Trumpin.

Ashtu si Trump, Merz kishte punuar 10 vjet si afarist me firmë të njohur amerikane, çka Trump e çmon. Shto këtu dhe faktin që falë anglishtes së kënaqshme, dhe në shenjë mirësimi ndaj bashkëbiseduesit, Merz nuk mori

përkthyes. Trump e vlerësoi këtë, duke nënvizuar aksentin e këndshëm gjerman të anglishtes së Merz.

Kësisoj, dhe me “revolucionin” e tij në fushën e mbrojtjes, duke shpallur Gjermaninë si fuqia e ardhëshme më e madhe ushtarake në Europë dhe realizimin e objektivit prej 5 për qind të GDP-së për shpenzimet mbrojtëse, Merz e kishte siguruar pothuajse të kaluar testin.

Merz nuk bëri asnjë gabim; kjo dhe për faktin se gjatë 45 minutave të takimit, ai foli vetëm 4 minuta, për shkak të monologimit të vazhdueshëm të Trump. Merz e kaloi me finesë dhe ndërhyrjen pa takt të Trump për operacionin

e famshëm ushtarak të aleatëve në Normandi duke e quajtur “ditë të keqe për gjermanët”, me mirënjohje për SHBA-të që çliruan Gjermaninë dhe se ajo kishte në dorë dhe fundin e luftës në Ukrainë. Pranimi i ftesës për vizitën në Gjermani nga Trump ishte “qershiza mbi tortën” e takimit. Shkurt hesapi, Merz e “kaloi provimin” me notë pothuajse të shkëlqyer. Sa për përmbajtjen e bisedës, Ukrainën, Lindjen e Mesme, tarifatat doganore, ato pak rëndësi kishin në atë takim. Përcaktuese ishte forma, që Merz doli i nderuar, duke shmangur çdo incident, duke e mbajtur mirë të paktën dhe për ca kohë me Trumpin. Gjithsesi, ekspertët paralajmërojnë Kancelarin Merz se herën tjetër duhet të takohet me Trump jo më për të marrë një “dëftesë pjekurie” por me përmbajtje dhe arritje të dukshme; mirëpo, kjo kërkon një Gjermani shumë më të fortë ekonomikisht, politikisht dhe ushtarakisht.

2.

Çmenduri politike është kjo që po ndodh në Prishtinën zyrtare. Edhe raundi i 32 për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit dështoi. Pa asnjë shans dhe perspektivë, vetëm inat, “tërheqje litari” dhe skenarë jashtë realitetit. Më parë këtë e kemi quajtur “turp politik” por tani kjo është çmenduri politike. Dhe ndodh tamam kur Kosova po kërkon të hyjë në KiE, të çelë negociatat me BE-në, etj. Kur duket se i mungojnë elementët jetikë të vlerave dhe parimeve Euro-Atlantike – fryma e tolerancës, lëshimit, kompromisit dhe konsensusit mbarëpartiak. Mirëpo pa këto komponentë, të tjerat janë “pesë me hiç”. Padyshim që fajtori kryesor është shumica parlamentare, e cila këmbëngul “më keq se mushka”



për kandidaturën e saj. Kjo nuk ka ndodhur as në vendet më të prapambetura afrikane. Çfarë dhurate e bukur për Beogradin, për ta telendisur akoma më keq Prishtinën lidhur me njohjen, asociacionin, etj. Mendoni thonë ata nëpër botë, kur këta nuk zgjedhin dot kryetaren e Kuvendit, si mund të merremi vesh me ta? I rroftë Presidentes Osmani që po i bie botës kryq e tërthor botës, pa e kuptuar se të keqen më të madhe Kosova e ka nga brenda dhe pastaj nga jashtë!

Ndaj, ju lutemi, jipni fund kësaj maskarade të paparë politike!

3.

3. 5 për qind ose ndryshe mësoni rusisht! Ky ishte ultimatum i Sekretarit të Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte dha në një takim në Londër më 5 Qershor dhe në Romë më 10 Qershor aleatëve të Aleancave të Aleancës dhe Ministrave të Jashtëm të Nismës Vajmar + . Duhet patjetër të realizohet kuota prej 5 për qind e GDP-së për NATO-n; ndryshe, paralajmëroi ai seriozisht, mund të keni shtet social dhe logjistikë moderne, por ama duhet të mësoni rusisht!. Duke iu referuar parashkimeve të besueshme mbi mundësinë e një sulmi rus dhe ndaj ndonjë vendi anëtar të NATO-s, kur të ketë mbaruar punë më Ukrainën. Ky ultimatum i drejtë i paraprin Samitit të NATO-s në Hagë më

24 – 25 Qershor dhe atij të BE-së më 30 Qershor.

4.

Lindja e Zjarrtë! Kështu mund të quhet tani Lindja e Mesme pas operacionit masiv që Izraeli ndërmori me shumë sukses dhe precizion natën e 12 Qershorit kundër lidërshpimit dhe bazave ushtarake e bërthamore të Iranit, me pasojat tashmë të njohura, përfshirë shkatërimin e centralit më të madh bërthamor të Nantanzit. Me pasojat të mëdha për të gjithë rajonin dhe botën dhe me rrezikun e përhapjes së flakëve të luftës akoma më gjerë.

Izraeli ishte në të drejtën e vet për vetëmbrojtje, kur dihet se Irani e ka shpallur botërisht objektivin për asgjësimin e shtetit të Izraelit. Tel Avivi shfrytëzoi dobësitë e Iranit pas disfatave të huthëve dhe Hisbulahut, shkatërrimit të mbrojtjes së tij ajrore vitin e kaluar, avancimit në prodhimin e bombës bërthamore dhe mungesës së perspektivës së bisedimeve amerikano- iraniane. Gjithsesi, tani kërkohet ndërhyrja e diplomacisë për të mos u përshkallëzuar më tej situata dhe flakët e luftës. Shqetësimi tjetër madhor lidhet me pasojat për Ukrainën, lufta dhe mbështetja ndaj të cilës po lihet në hije. Dhe kjo ka të ngjarë të ndodhi qysh tani me Samitin e G-7 në Kanada (14 – 16 Qershor) dhe në atë të NATO-s në Hagë më 24/25 Qershor.

SULMI AMERIKAN NDAJ IRANIT

Kryeministri Rama: Shqipëria mbështet përpjekjet e Trump kundër Iranit bërthamor



Kryeministri Edi Rama reagoi sot, pasi presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump njoftoi se SHBA ka përfunduar sulmet ndaj tre objekteve bërthamore në Iran, përfshirë Fordow, Natanz dhe Esfahan.

Në një postim në platformën X, kreu i qeverisë shkruan se “ky nuk është thjesht një shtet tjetër bërthamor. As thjesht një diktaturë me ambicie bërthamore”.

Rama shprehet se “kjo është një teokraci, e armatosur me retorikë apokaliptike, e zhytur në vite të pafundme të etiketimit të kombeve të lira si “satanike” dhe thirrjes së hapur për shfarosjen e tyre”.

Kryeministri Rama nënvizon se “nga çdo aspekt, është një devijim i veçantë, ndryshe nga çdo shtet i armatosur me armë bërthamore,

pavarësisht sistemit politik”.

